



Procesverbal 1/2025

I mbajtur në mbledhjen e I-rë të Komitetit për Komunitete, në Kryesimin e Osman Eminit - Kryesues i Komitetit për komunitete, mbledhja u mbajt me datën 29.01.2025 në ora 10.00 në zyrën e takimeve të Kryetari i komunës.

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e Komitetit për komunitete;
 2. Miratimi i rendit të ditës;
 3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të Komitetit për Komunitete;
 4. Diskutim për ankesat e qytetarëve në shërbim shëndetësor;
 5. Diskutim dhe rekomandim nga Komiteti për Komunitete si të ndikojmë në siguri dhe mirëqenie shëndetësore për qytetarët;
 6. Planifikim i Planit të punës të Komitetit për Komunitete për Vitin 2025 dhe
 7. Të ndryshme.
-
1. Kryesues i Komitetit për komunitet Osman Emini – Konfirmoi pjesëmarrjen në mbledhje – Prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për komunitete;
 2. U miratua rendi i ditës pa ndonjë vërejtje;
 3. Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

Kryesues i Komitetit për komunitet Osman Emini – Kemi ankesa nga qytetarët për Ambulantën Nr. 4 në Sallahane, që të punojë me orar siç ka qenë më herët.

Qytetarët kërkojnë që të punojë Ambulanta e QKMF-së me orar siç ka qenë më herët, pasi që gjatë këtij orari të rri ka shumë tollovi, ku shumë njerëz të cilët presin krijojnë probleme për rend.

Kryesues i Komitetit për komunitet Osman Emini – Sa i përket sigurisë ka disa raste të cilat po i ndalim në qytetin tonë si dhe raste tek komuniteti edhe tek shumica. Kërkojmë nga organet kompetente që të shtohet patrulla, të shtohen intervenimet për siguri më të mirë.

Flora Abdullahu – Të takohemi me komandantin e policisë për të diskutuar. Nga KK-ja të kërkojmë që ta ketë një ditë pune për përgatitjen e Planit të punës dhe kërkojmë nga komuna që ta ndihmoj në realizimin e saj.

Procesmbajtësi


Xhemajl Jashari

Kryesuesi i Komitetit për komunitete


Osman Emini

